

Njoftim për Media

INSTAT kontribuon në politikat statistikore ndërkombëtare përmes anëtarësisë në Bordin e PARIS21

Tiranë, më 28 Prill 2015:

Shqipëria bëhet pjesë e iniciativës PARIS21 (Partneriteti në Statistika për Zhvillimin në shekullin e 21^{-të}) përmes INSTAT, duke iu dhënë shansi unik të jetë pjesëmarrëse aktive në politikat më elitare në fushën e statistikave në nivel ndërkombëtar.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, Z. Gjergji Filipi është emëruar anëtar i Bordit të kësaj strukture dhe përfaqëson vendet e rajonit të Evropës Lindore dhe Konfederatës së Shteteve të Pavarura, si dhe është anëtar i Grupit të Referencës së Ekspertëve për rishikimin e Udhëzuesit për hartimin e strategjive kombëtare të zhvillimit të statistikave në vendet në zhvillim.

PARIS21, është një platformë e bashkëpunimit statistikor e themeluar në 1999 nga Kombet e Bashkuara, Komisioni Evropian, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, në përgjigje të Rezolutës së Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së mbi objektivat e Konferencës së OKB-së për Zhvillimin.

Iniciativa PARIS21 përbën një forum që ka për qëllim të ndikojë në forcimin e dialogut në shoqëri dhe përdorimin e statistikave për një qeverisje dhe politikë-bërje të bazuar në të dhëna, të ndikojë në përmirësimin e disponueshmërisë dhe përdorimit të statistikave me cilësi të lartë si dhe të promovojë rritjen e mirëqenies së shoqërisë duke kontribuar në përmbushjen e objektivave të zhvillimit kombëtar. Kjo strukturë qeveriset nga një Sekretariat, i cili ka selinë në zyrat qendrore të OECD në Paris.

Pjesëmarrja në këtë Bord, nën përfaqësimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, është me rëndësi në rritjen e ndikimit, vizibilitetit të Shqipërisë dhe kontributit të saj nëpërmjet ekspertizës së Institutit tonë kombëtar të statistikave, në zhvillimin e statistikave dhe promovimin e përdorimit të tyre në rajon dhe më gjerë.

Bordi mbledhet një herë në vit për të diskutuar çështje që lidhen me zhvillimin dhe përdorimin e statistikave në përgjithësi dhe për të rishikuar programet e punës. Ky Bord përbëhet nga 46 anëtarë, 7 prej të cilëve janë me përfaqësi të përhershme dhe pjesa tjetër me mandat të rinovueshëm, janë përfaqësues të zyrave kombëtare statistikore, përdorues të të dhënave, përfaqësues të bankave të zhvillimit, organizatave ndërkombëtare, donatorë të statistikave dhe përfaqësues të biznesit.

Përbërja e Bordit për 2015 përbëhet në total nga 127 vende me përfaqësi: (i) të institucioneve statistikore të shteteve të zhvilluara si Australia, Kanadaja, Gjermania, Belgjika, Holanda, Italia, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Zvicër, Norvegji, Kore; të vendeve në zhvillim të Afrikës, Lindjes së Mesme, Azisë Jugore, Azisë Lindore dhe Pacifikut, Azisë Juglindore, Amerikës Qendore dhe Karaibeve, Amerikës Jugore dhe Evropës Lindore dhe Konfederatës së Shteteve të Pavarura; (ii) nga organizatat ndërkombëtare statistikore dhe donatorë si Fondi i Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Organizata Botërore për Shëndetësinë, Instituti i Statistikave të UNESCO-s; AFRISTAT, ASEAN, etj; (iii) nga Bankat për Zhvillim (iv) nga biznesi me përfaqësues nga Fondacioni Bill Gates.

Anëtarët me përfaqësi të përhershme në Bord janë përfaqësuesit e Komisionit Evropian/Eurostat, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Organizatës për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Departamentit për Statistikat e Kombeve të Bashkuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, Bankës Botërore dhe Sekretariatit të Paris21.

Detyrat e anëtarit të Bordit dhe të Grupit të Grupit të Referencës së Ekspertëve janë:

- të diskutojë dhe të kontribuojë në lidhje me përcaktimin dhe zhvillimin e objektivave të Paris21 dhe orientimin për të ardhmen, për çështje të zhvillimit dhe të përdorimit të statistikave në përgjithësi dhe në rishikimin e programit të punës.
- të ofrojë orientim në lidhje me rishikimin dhe përditësimin dhe miratimin e ndryshimeve të Udhëzuesit për hartimin e strategjive kombëtare të zhvillimit të statistikave në vendet në zhvillim.
- Të kontribuojë në punën që Paris21 duhet të bëjë për të përgatitur komunitetin statistikor mbi kërkesat e Axhendës së Zhvillimit Post – 2015.
- Të kontribuojë në promovimin dhe forcimin e rolit të statistikave në vendim-marrje, në zhvillimin dhe prodhimin e treguesve të zhvillimit të qendrueshëm.
- Të kontribuojë në promovimin dhe informimin e komunitetit statistikor dhe më gjerë mbi revolucionin e të dhënave dhe impaktin që kjo do të ketë në rolin e zyrave kombëtare statistikore dhe statistikave zyrtare.

Takimi vjetor i Bordit për vitin 2015 u organizua në Prill 2015 në Paris. Disa nga çështjet që u diskutuan përfshinin diskutimet mbi rolin e statistikave në zhvillimin dhe prodhimin e treguesve të zhvillimit të qendrueshëm, informacionin mbi udhërrëfyesit për informimin mbi revolucionin e të dhënave, përditësimin mbi punën e kryer për Udhëzuesin për hartimin e Strategjive Kombëtare për Zhvillimin e Statistikave, përcaktimin e rolit dhe objektivave të kësaj platforme për periudhën në vijim 2016 – 2020.